



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1330 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2022

VENDIM

Nr. 515, datë 18.11.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji Gjergji Vinjahu, në kuadër të projektit “Green Coast Resort 2 Zona W, Rezidencial-Vilal dhe 2 kat, pishinë dhe mur rrethues, Palasë Vlorë”, me aplikues Gjergji Vinjau dhe zhvillues dhe investitor “Seaside Residence II” sh.p.k. dhe “Green Coast” sh.p.k.;
2. Investitori duhet të lidhe paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryejn e punimeve për projektin, si dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt. Më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

